



Datë: 16.09.2025
Numër Protokolli: 6349/2025

A.nr.1335/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1317/2025 të datës 08.07.2025, të parashtruar nga ankuesi E.G, dhe ankesës me numër A.nr.1335/2025 të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesi N.K, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Agim Salihu, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1335/2025, e datës 09.07.2025, e parashtruar nga ankuesi E.G dhe ankuesi N.K.

II. Anulohet në tërësi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit me Numër Reference: RN00017271, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” i Thesarit të Kosovës dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshme i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, ashtu sikurse është përcaktuar në piken II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, E.G dhe N.K (në *tekstin e mëtejme referuar*: ankuesit), më datë 08.07.2025, respektivisht me datë 09.07.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017271, për pozitën e punës së Kategorisë së Lartë Drejtuese “*Drejtor Ekzekutiv*” i Thesarit të Kosovës, i shpallur me datë 21.03.2025 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.07.2025 dhe 18.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit më datë 25.07.2025, ka

përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 5664/2025, të datës 22.08.2025, ka bërë bashkimin e ankesës me numër A.nr.1317/2025 të datës 08.07.2025, të parashtruar nga ankuesi E.G dhe ankesës me numër A.nr.1335/2025 të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesi N.K, ashtu që ankesat kanë marrë numrin e ankesës së fundit A.nr.1335/2025 të datës 09.07.2025.

Ndërsa, Kryetari I Këshillit pas pranimi të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, përmes Vendimit VK/2025 dhe numër protokolli 5654/2025, të datës 22.08.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1335/2025 të datës 09.07.2025, edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4565/2025 të datës 08.07.2025, të parashtruar nga ankuesi E.G, në Këshill; E-mailin e datës 10.06.2025; E-mailat e datës 09.06.2025; E-mailin e datës 05.06.2025; E-mailin e datës 16.05.2025; Vendimin me numër protokolli 1330/2025 të datës 02.05.2025; Lista përfundimtare e vlerësimit e datës 09.06.2025; Njoftimin e datës 16.05.2025; Konkursin me numër reference RN00017271; Dokument identifikimi i ankuesit E.G; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.07.2025; Ankesën me numër protokolli 4806/2025 të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesi N.K, në Këshill; Autorizimin e datës 09.07.2025; Vendimin për pushim; E-mailin e datës 30.05.2025; E-mailin e datës 04.06.2025; E-mailat e datës 09.06.2025; Shkresa nga SIMBNJ; Njoftimin e datës 09.06.2025; Dokument identifikimi i ankuesit, N.K; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.07.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 25.07.2025; E-mailat e datës 05.06.2025, 04.06.2025, 03.06.2025 dhe 30.05.2025; E-mailin e datës 18.03.2025; Vendimin Nr.06/260 të datës 29.05.2025; Akt emërimit me numër protokolli 2458/2024 të datës 25.09.2024; Vendimin Nr.08/132 të datës 08.03.2023; Vendimin Nr.08/130 të datës 22.02.2023; Vendimin me Nr.Ref.KM-153/24 të datës 08.04.2024; E-mailin e datës 04.04.2024; Vendimin Nr.13/151 të datës 12.07.2023; Vendimin Nr.18/112 të datës 13.12.2022; Pyetjet e intervistës së datës 09.06.2025; Formularët e datës 02.06.2025, të vlerësimit të esesë; Renditja përfundimtare e datës 09.06.2025; Procesverbal i datës 09.06.2025; Esetë e kandidatëve; Formularët e datës 09.06.2025, të vlerësimit të intervistës me gojë; Aplikacionin e kandidatit S.B, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 18.04.2025 në konkursin përkatës; Njoftimin e datës 15.05.2025, për kandidaten H.S; Aplikacionin e kandidates H.S, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 02.04.2025 në konkursin përkatës; Njoftimin e datës 16.05.2025, për V.T; Aplikacionin e kandidatit V.T, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 18.04.2025 në konkursin përkatës; Njoftimin e datës 16.05.2025, për V.T; Aplikacionin e kandidatit Zh.S, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 13.04.2025 në konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidatit S.T, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 07.04.2025 në konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidatit M.I, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 04.04.2025, në konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidatit L.I, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 19.04.2025, në konkursin përkatës; Aplikacionin e ankuesit N.K, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 18.04.2025, në konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidatit G.H, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 04.04.2025, në konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidates K.B, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 14.04.2025, në konkursin përkatës; Aplikacionin e ankuesit E.G, me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit të datës 16.04.2025, në konkursin përkatës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, **është e bazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i provave të lëndës, ka gjetur se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00017271, për pozitën e punës të Kategorisë së Lartë Drejtuese “Drejtor Ekzekutiv” i Thesarit të Kosovës, me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025, ku sipas pikës 3 të këtij konkursi, kërkesa të përgjithshme formale, kanë qenë këto:

- **a) Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Ekonomik (pa specifikim).

- **b) Kërkesat specifike:** Nuk ka.

- **c) Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijmë:

c.1.) pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose

c.2.) katër (4) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose

c.3.) tre (3) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës).

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kandidatë, ku prej tyre tetë (8) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesit, të cilët kanë marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit, si rrjedhojë, ankuesi N.K ka arritur gjithsejtë 83.6 pikë dhe është përfshirë në listën e kandidatëve fitues, ndërsa ankuesi E.G ka arritur gjithsejtë 58.8 pikë, të pamjaftueshme për të hyrë në listën e kandidatëve fitues.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, gjegjësisht me datë 09.06.2025, ka publikuar Listën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve, nga rezulton se procedurë e rekrutimit për pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese “Drejtor Ekzekutiv” i Thesarit të Kosovës, ka përfunduar me tre (3) kandidatë fitues, të cilët kanë arritur pragun e kalueshmërisë prej 70 pikëve, dhe atë duke u renditur sipas pikëve të arritura, sikurse në vijim: nga kandidati L.I me gjithsejtë 87.2 pikë, pasur nga ankuesi N.K me gjithsejtë 83.6 pikë, si dhe kandidatja K.B me gjithsejtë 74.4 pikë të përgjithshme.

Ankuesit, kundër njoftimit të lartë theksuar kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve ligjore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, andaj kërkojnë aprovimin e ankesës, rrjedhimisht anulimin e konkursit përkatës.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, lidhur me hapat fillestar të ndërmarrë nga kjo procedurë e rekrutimit, gjegjësisht shpallja e konkursit me numër referencën RN00017271, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Thesarit të Kosovës, i ’u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht:

-Nenit 16, paragrafi 1, i cili përcakton se: *1. Çdo institucion që punëson zyrtarë/ë publik në fushën e veprimit të këtij ligji, duhet të ketë Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në përputhje me*

kriteret e përcaktuara në ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive”

- Nenit 47 paragrafi 2, i cili përcakton se: “Procedura e rekrutimit organizohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike për institucionet e administratës shtetërore dhe nga njësia përgjegjëse, për çdo institucion tjetër shtetëror”, ndërlidhur me dispozitat kalimtare nga Neni 98 paragrafi 1 dhe 2 i të njëjtit ligj, ku përcaktohet se: 1. Pavarësisht dispozitave të këtij ligji, procedura e centralizuar e rekrutimit për shërbyeset/it civil që zhvillohet nga njësia përgjegjëse në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, do të fillojë të zbatohet tetëmbëdhjetë (18) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 2. Deri në periudhën sipas paragrafit 1. të këtij neni, NjMBNj e institucionit përkatës do të zhvillojë procedurën e rekrutimit.; si dhe bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L119 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht nenit 1 ku theksohet se:

-1. Ky ligj përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës. 2. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër ligjor për themelimin, organizimin, funksionimin, përgjegjshmërinë dhe performancën e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura.;

-Nenit 9, ku përcaktohet se: 1. Administrata shtetërore përbëhet nga Zyra e Kryeministrit, sistemet ministrore dhe agjencitë rregullatore. 2. Sistemi ministror përbëhet nga: 2.1. ministria; 2.2. agjencia ekzekutive, dhe 2.3. administrata e shërbimeve publike.; si dhe,

- Nenit 26, i cili përcakton se: 1. Agjencia Ekzekutive dhe ajo Rregullatore organizohet si një apo disa departamente në bazë të fushëveprimtarisë. Niveli i organizimit përcaktohet në pajtim me këtë ligj. 3. Shërbimet e përgjithshme të menaxhimit , menaxhimit financiar, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të auditimit të brendshëm në agjencitë ekzekutive, me një numër punonjësish më të vogël se pesëdhjetë (50), kryhen nga njësia përgjegjëse administrative e ministrisë përgjegjëse. 4. Në rastin e agjencive ekzekutive të mëdha dhe me veprimtari komplekse, si dhe agjencive rregullatore, njësitë administrative që kryejnë shërbimet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, krijohen brenda agjencisë dhe i raportojnë drejtpërdrejt drejtorit apo organit drejtues kolegjal të agjencisë rregullatore.

Rrjedhimisht, referuar këtyre dispozitave ligjore dhe shkresave të lëndës, e ndërlidhur me nenin 105 të Ligjit Nr.08L-197 për Zyrat Publike, i cili ka përcaktuar se: Ky ligj hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.; dhe se duke u bazuar në datën e publikimit 18.09.2023 të këtij ligji, nga rezulton se i njëjti ka hyrë në fuqi më datë 25.09.2023, ndërsa shpallja e konkursit përkatës është e datës 21.03.2025, apo thënë më konkretisht para kalimit të periudhës kohore prej 18 muajsh që nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe në këtë kuptim të dispozitave të lartë theksuara ligjore si dhe duke pasur parasysh se Thesari i Kosovës, është Agjenci Ekzekutive me një numër më të madh se pesëdhjetë (50) punonjës, që brenda saj ka të krijuar edhe Njësine për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, si rrjedhojë, dhe se duke qenë se në rastin konkret ekziston gjendja e njëjtë faktike dhe juridike, **sikurse në rastin e vendimmarrjes për ankesën me numër A.nr.505/2025, për procedurën e rekrutimit për Kryeinspektor të Inspektoratit Qendrorë të Punës, si dhe ankesën me numër 789/2025, për procedurën e rekrutimit për Drejtor Ekzekutiv të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës**, dhe duke u mbështetur në nenin 8, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: 1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme.; si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se shpalljen e konkursit numër reference RN00017271, për pozitën e punës të Kategorisë së Lartë Drejtuese Drejtor Ekzekutiv në Thesarin e

Kosovës, duhej ta shpallte njësia e sapo theksuar, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet fakti i pa kontestueshëm se në rastin konkret, shpalljen dhe zhvillimin e procedurës përkatëse të rekrutimit e ka realizuar NJMBNJ e Ministrisë amë përkatësisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Tutje, Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës, konstaton se Komisioni Ad-hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim në Pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv i Thesari të Kosovës, është themeluar me Vendimin Nr.06/260 të datës 29.05.2025, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, dhe atë në përbërje nga:

- V.Ç, kryetare, e cila sipas Vendimit me Nr.Ref.KM-153/24 të datës 08.04.2024, është transferuar në mënyrë të përhershme për interes të institucionit, nga pozita e Drejtoreshës Ekzekutive të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, në pozitën Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

- A.K, anëtare, e cila sipas Vendimit Nr.13/151 të datës 12.07.2023, mbanë pozitën e Sekretares së Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë;

- N.G, anëtar, i cili sipas Vendimit Nr.08/132 të datës 08.03.2023, mbanë pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Akreditim;

- R.M, anëtare, e cila sipas Akt emërimit me numër protokolli 2458/2024 të datës 25.09.2024, mbanë pozitën e punës **Zyrtare e Lartë e Personelit-Klasa Profesional 1**, në Divizionin e Burimeve Njerzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; si dhe,

- V.A, anëtar/ekspert i jashtëm.

Rrjedhimisht, referuar nenit 48 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni shtetëror i pranimit. 2. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në një institucion tjetër shtetëror, bëhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Komisioni shtetëror i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese në administratë shtetërore, apo komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 3.1. tre (3) nëpunës/ës ekzistues në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese; 3.2. udhëheqësen/in e njësisë përgjegjëse; 3.3. një (1) eksperte/t i jashtëm.; dhe se pavarësisht konstatimit të lartë theksuar lidhur me kompetencën e shpalljes së konkursit, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se me rastin e emërimit të këtij Komisioni nuk janë respektuar këto kërkesa ligjore, ngase në përbërje të tij nuk është caktuar dhe rrjedhimisht nuk ka marrë pjesë në vlerësim Udhëheqësi/ja e Njësies Përgjegjëse, duke vepruar në kundërshtim edhe me nenin 23 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.*

Më tej, Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të procedurës përkatëse të rekrutimit, ka analizuar listën e ngushtë të kandidatëve të përfshirë në Njoftimin e datës 16.05.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, dhe me qëllim të vërtetimit se tetë (8) kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë plotësojnë apo jo kërkesat e përgjithshme formale të lartë theksuara, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e*

veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 2.Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Ndërsa, sipas nën pikës 3 dhe 5 të pikës 5 të konkursit me numër reference RN00017271, të datës 21.03.2025, rezulton se gjithë kandidatët kanë qenë të njoftuar lidhur me dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit, ku është përcaktuar se:-Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen dhe angazhimin në atë pozitë. Dëshmisë së punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organit kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.- Kopjet e dokumenteve tjetra që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, bazuar dispozitat e lartë theksuara ligjore, kërkesat e përgjithshme formale të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës dhe dokumentet e kërkuara mbi dëshmimin e përvojës së punës të pasqyruara si më sipër, nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës konstaton se kandidati G.H, me rastin e aplikimit të datës 01.04.2025, lidhur me plotësimin e kriterit arsimor ka bashkangjitur Diplomën me Nr.680 të lëshuar me datë 10.06.2019, nga Kolegji “AAB”, me të cilën dëshmohet se i njëjti me datë 17.08.2008 ka mbaruar studimet themelore universitare në Departamentin: Marketing dhe Administrim Biznesi, duke fituar kështu titullin Bachelor për Marketing dhe Administrim Biznesi.

Ndërsa, sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës së punës së lartë theksuar, kandidati G.H ka bashkangjitur këto dokumente: Vërtetimin e marrëdhënies së punës të lëshuar me datë 02.08.2023, nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes së cilës theksohet se i njëjti ka qenë i punësuar tek ky institucion në pozitat: Ekspert i Sigurisë së Produkteve si dhe Inspektor i Tregut në Inspektoratin e Tregut, me llojin e kontratës “Marrëveshje për Shërbime të Veçanta”, nga këto data: 10.05.2019 - 09.11.2019 (6 muaj); 15.01.2020 – 15.04.2020 (3muaj); Inspektor i Tregut nga data 26.06.2020 – 26.12.2020 (6muaj) dhe nga data 08.02.2021 – 07.08.2021 (6muaj); -Kontratën e punës të datës 01.12.2021, përmes të cilës dëshmohet se i njëjti nga data 01.12.2021 deri më 01.06.2022(6muaj), ka qenë i angazhuar tek punëdhënësi i sektorit privat “Vita Land”, në pozitën e punës Konsulent; -Kontratën e punë për kohë të caktuar, të datës 01.03.2024, përmes të cilës dëshmohet se i njëjti nga data 01.03.2024 deri më datë 28.02.2025, ka qenë i punësuar tek Avokat Mentor Beqiri L.L.C, në cilësinë e Konsulentit, mirëpo duke qenë se e njëjta përvojë pune është në sektorin privat të njëjtit në Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional, i figurojnë 12 muaj kontribute pensionale të paguara tek ky punëdhënësi i fundit.

Mirëpo, për 47 muajt kontribute pensionale të cilat figurojnë në Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional, tek punëdhënësi Krasniqi dhe D.P.H. “AM PM CANTINA”, rezulton se kandidati i lartë theksuar nuk ka bashkangjitur kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga punëdhënësit përkatës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë, ashtu siç edhe është kërkuar me shpalljen e konkursit përkatës, dhe si për rrjedhojë Kolegji Këshillit konstaton se kandidati në fjalë nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës së lartë theksuar, ngase i njëjti me anë të këtyre dokumenteve ka dëshmuar se posedon vetëm **3 vite e 3 muaj** përvojë pune profesionale pas diplomimit, dhe se përfshirja e tij në listën e ngushtë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 44 paragrafi 5 dhe 6, ku përcaktohet se: *5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese.*

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit, konstaton se shpallja e konkursit me numër reference RN00017271, për pozitën Drejtorit Ekzekutiv të Thesarit të Kosovës, është realizuar nga organi jo kompetent, veprime këto në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të Nenit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.;* dhe se për shkak të kësaj dhe konstatimeve si më sipër, ka bërë që procedura e rekrutimit që nga shpallja e deri tek njoftimi përfundimtar i datës 09.06.2025 të zhvillohet në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr.06/L119 për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, Rregullores (QRK) Nr. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.15/2023, dhe se për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017271, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” i Thesarit të Kosovës, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1335/2025.

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit E.G si dhe përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit N.K, Avokatit Agim Salihu;
- Sekretarit të Përgjithshëm dhe Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

infosot